



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 823 prot.

Ballsh më, 22 . 02 .2023

VENDIM

Nr. 07 Datë 21/02/2023

“PËR MIRATIMIN E VLERËS SË DËMIT TË SHKAKTUAR QYTETARËVE, SI PASOJË E PUNIMEVE TË KRYERA PËR PROJEKTIN “NDËRTIMI I LINJËS SË JASHTME TË UJËSJELLËSIT RAJONAL MALLAKASTËR”

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, VKM nr. 138, datë 23.03.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, Udhëzimit nr. 1, datë 05.10.2000 “Për kriteret teknike të përlllogaritjes së vlerës së bimëve dru frutore që shpronësohen për interes publik, në rastet kur mungojnë treguesit e deklaruar të shitblerjes”, VKB nr. 63, datë 22.12.2020 “Për miratimin e projektit të hartuar me objekt : Ndërtim linje transmetimi rrjeti i jashtëm i ujësjellësit rajonal Ballsh dhe miratimin në parim për shpronësimin e pronave që mund të preken nga zbatimi i këtij prjektiprocesverbaleve të konstatimit dhe vlerësimit të grupit të punës,

VENDOSI

1. Miratimin e vlerës së dëmit në total të prej **628 600 (gjashtëqind e njëzete e tetë mijë e gjashtëqind) lekë** sipas tabelës bashkëlidhur.
2. Këto dëme në pronat e përfituara nga Ligji 7501 “Për Tokën” janë shkaktuar si pasojë e punimeve që po kryhen për procedurën me objekt “Ndërtim linje transmetimi rrjeti i jashtëm i ujësjellësit rajonal Ballsh”.
3. Vlerësimi paraprak është përlllogaritur sipas VKM nr. 138, datë 23.03.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të drejtave të personave të tretë, për interes publik” si dhe Udhëzimit nr. 1, datë 05.10.2000 “Për kriteret teknike të

përlogaritjes së vlerës së bimëve dru frutore që shpronësohen për interes publik, në rastet kur mungojnë treguesit e deklaruar të shitblerjes.

4. Bashkia Mallakastër merr përsipër pagesën e gjithë vlerës nga buxheti i vetë, artikulli 602.
5. Ky vendim shoqërohet me tabele përmbledhëse dhe relacion shpjegues.

KRYETAR

Fitim Baraj

